



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 korrik 2019
Nr. ref.: RK 1399/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI173/18

Parashtrues

Nijazi Pasoma

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1614/2016,
të 27 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nijazi Pasoma, me vendbanim në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1614/2016, të 27 korrikut 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 nëntor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
7. Më 20 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
8. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë.
9. Më 6 qershor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 20 tetor 2012, kreditori TEB Banka sh. a., parashtruesi i kërkesës dhe debitorë të tjerë nënshkruan marrëveshjen mbi kredinë nr. 23563, në shumë prej 75,000 € dhe më 18 gusht 2011 marrëveshjen për mbritërheqje nr. 14974, në shumën prej 8,000 € për nevoja të ndërmarrjes "Kotex" sh.p.k me numër biznesi 70700913, me seli në Vushtrri.
11. Më 5 korrik 2015, kreditori TEB Banka sh. a., tek përmbaruesi privat parashtrroi propozim për përmbarim, përkatësisht për shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara për shkak të mos shlyerjes së detyrimeve ndaj tij, me propozimin vijues: *"Pranohet plotësisht propozimi për përmbarim i*

Kreditorit Banka TEB SH.A. dhe urdhërohet përmbarimi për pagesën e borxhit në vlerën prej 50,397.93€”.

12. Më 8 korrik 2015, përmbaruesi privat me Vendimin P. nr. 529/15, lejon propozimin për përmbarim, të ushtruar nga kreditori TEB sh. a., përkatësisht shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara.
13. Më 30 nëntor 2015, shpallet konkluzioni për shitjen e paluajtshmërive të hipotekuara, përkatësisht prona e parashtruesit të kërkesës e evidentuar me nr. 011-953-5732/2012, ngastra kadastrale nr. P-71914075-00296-8, me sipërfaqe prej 374 m2, dhe prona e debitorit R. H., e evidentuar në certifikatën e pronës UL-70202018-00197, të 21 gushtit 2012, ngastra kadastrale me nr. P-70202018-00911-5, me sipërfaqe prej 425 m2.
14. Më 5 janar 2015, mbahet ankandi i parë publik dhe në këtë rast nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerjen e paluajtshmërive të hipotekuara, gjithashtu edhe në ankandin e dytë, të mbajtur më 3 shkurt 2015, nuk kishte ofertë për blerjen e paluajtshmërive në fjalë.
15. Më 1 mars 2016, mbahet ankandi i tretë publik dhe blerës i paluajtshmërive të hipotekuara shpallet kreditori TEB banka sh. a.
16. Më 8 mars 2016, përmbaruesi privat nëpërmjet urdhrit përmbarimor P. nr. 529/15, cakton si blerës kreditorin TEB Bank sh. a., e cila ofroi shumën prej 20.668,00 € për blerjen e paluajtshmërive të hipotekuara. Për pjesën e borxhit të mbetur prej 28.116, 03, €, kreditori u udhëzua që të realizojë në një procedurë tjetër.
17. Kundër këtij urdhri, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se vlera e kolateralit e lënë peng e ka pasur fuqinë e plotë për ta kryer obligimin e kredisë, por e njëjta është anashkaluar nga kreditori duke bërë shkelje thelbësore të disa dispozitave që dalin nga marrëveshja mbi kredinë, si dhe shkelje përkitazi me paluajtshmërinë P-71914075-00269-8, e cila ndodhet në Prishtinë, duke u thirrur në shkelje të kompetencës territoriale, siç parashihet me nenin 177 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
18. Më 27 korrik 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 1614/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me urdhrin përmbarimor të 8 marsit 2016, me arsyetimin: *“Pretendimet ankimore të debitorëve kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara pasi që gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e të drejtës materiale të cekura në arsyetimin e urdhrit të atakuar-dispozitën e nenit 234 par.6 të LPP-së me rastin e shitjes së paluajtshmërive në ankandin e tretë publik”.*
19. Më 3 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të 27 korrikut 2018.

20. Më 23 tetor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës, se kërkesa e tij nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për t'u aprovuar në bazë të nenit 247.1 a) dhe pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij si më poshtë:

Barazia para Ligjit

Sepse: "... në lëndën përmbartimore ka qenë në cilësinë e debitorit, edhe pse kredimarrësit kanë pasur mjete të mjaftueshme për ta shlyer detyrimin e tyre nëpërmjet kolateralit të tyre të lënë peng, organet kompetente, nuk e kanë respektuar procedurën sipas radhës së debitorëve, saktësisht sipas nenit 39 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore Ligji nr. 04/L-139, e me këtë veprim të organeve kompetente është shkelur barazia para ligjit, e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ngase debitorët e tjerë janë privilegjuar dhe nuk u është goditur masa e tyre pasurore, edhe pse të njëjtit kanë pasur kolateral të mjaftueshëm të lënë peng për shlyerjen e detyrimit".

E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

Nga shkaku se atij: "... nuk i është dhënë mundësia e paraqitjes së pretendimeve të tij, paraqitja e provave dhe fakteve, ku të gjitha procedurat lidhur me këtë çështje kanë qenë të padrejta dhe të anshme, ngase ndaj debitorëve të tjerë nuk është ndërmarrë asnjë masë, e cila është bashkëngjitur në formularin e kërkesës me nr. protokollit 1742, e datës 07.11.2018, sipas të cilit Përmbartuesi Privat, pa dijeninë e parashtruesit të kërkesës lejon shitjen e sendeve të lëna peng nga ana e debitorëve të tjerë, e ato mjete materiale nuk ia kalon kreditorit, për të shlyer detyrimin, mirëpo ia shet personave të tjerë, ndërsa mjetet materiale shkojnë në llogari të debitorëve të tjerë, ndërsa Përmbartuesi Privat, merr vendim me të cilin urdhërohet shitja e paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës i cili ka qenë i fundit sipas radhës, ndërsa mjetet materiale nga shitja e kolateralit të debitorëve kryesor, të cilat e kanë tejkaluar vlerën e borxhit ia jep debitorëve, e me këtë parashtruesit të kërkesës i shkakton dëm të pariparueshëm, pasi që është shkelur neni 1016 i LMD-së".

Mbrojtja e Pronës

Me pretendimin se "... në mënyrë arbitrare është privuar nga e drejta e pronës, e mbrojtur me Kushtetutë, ngase duke shkelur nenet e lartcekura të Kushtetutës, ka ardhur deri te privimi i të drejtës së pronës, pa kurrfarë baze juridike".

22. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që për çështjen e tij të merret vendim meritör.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...].”

25. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

26. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet efektive

juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe ka dorëzuar kërkesën në kohë.

27. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

Sa i përket pretendimit për shkelje të “barazisë para ligjit”

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se autoritetet kompetente nuk e respektuan procedurën sipas radhës së debitorëve, saktësisht sipas nenit 39 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore Ligji nr. 04/L-139 dhe se debitorët e tjerë janë privilegjuar dhe nuk iu është goditur masa e tyre pasurore, duke aluduar se të njëjtit kanë pasur kolateral të mjaftueshëm të lënë peng për shlyerjen e detyrimit.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 24 të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

*2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
(...)”.*

30. Gjykata, para së gjithash dëshiron të rikujtojë se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton barazinë e individëve që ndodhen në kushte të barabarta dhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj pa asnjë diskriminim. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori personash që janë në kushte objektivist të ndryshme të ketë trajtim dhe zgjidhje të njëjlojta.

31. Për më tepër, praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sqaron se, sipas kuptimit të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), një trajtim diskriminues konsiderohet vetëm atëherë kur “ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”, që do të thotë se, ai nuk ndjek një “qëllim legjitim”, apo kur trajtimi nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti “midis mjeteve të përdoruara dhe qëllimit që arrihet” (shih, për shembull gjykimin e 28 majit 1985 në çështjen *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, nr. 94, para 78).

32. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë elemente të shkeljes së barazisë para ligjit, përkatësisht elemente të trajtimit të pabarabartë, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara të nenit 24 të Kushtetutës, kur ky nen interpretohet në dritën e nenit 14 të Konventës nuk e justifikojnë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e kësaj të drejte themelore, sepse, ai në asnjë mënyrë nuk dëshmon dhe argumenton se gjykatat e rregullta e trajtuan atë në mënyrë ta pabarabartë, për ndonjërin nga format e diskriminimit që parashihet me nenin 24 të Kushtetutës.

Sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm”

33. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, pretendon se nga gjykatat e rregullta nuk i është dhënë mundësia e paraqitjes së pretendimeve, provave dhe fakteve dhe se ndaj debitorëve të tjerë nuk është ndërmarrë asnjë masë por vetëm ndaj tij.
34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështesë këtë pretendim në baza kushtetuese dhe të tregoj si dhe pse erdhi deri të shkelja e kësaj të drejte nga gjykatat e rregullta ose përse vendimet e tyre ishin arbitrare. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës shkeljen e kësaj të drejte e ndërlidhë me shkelje të nenit 1016 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.
35. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
36. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41).
37. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, rasti KI86/11, me parashtrues *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).

38. Nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës thjeshtë nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta, gjegjësisht me faktin se atij i është refuzuar ankesa e ushtruar kundër urdhrit të përmbarimit. Megjithatë, pakënaqësia e parashtuesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]

39. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendon edhe në shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës këtë pretendim e ndërlidhë me shkelje të së drejtës për barazi para ligjit dhe të gjykimin të drejtë. Megjithatë ai në mënyrë specifike nuk argumenton më tej, se si dhe pse erdhi deri të privimi i të drejtës së tij në pronë, respektivisht shkelja e nenit 46 të Kushtetutës nga gjykatat e rregullta. Andaj, për këtë arsye Gjykata edhe këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës e konsideron qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.
40. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtuesit të kërkesës duhet deklaruar qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, sepse argumentet e ngritura në kërkesë në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet e tij për shkelje të nenit 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës.
41. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 6 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

